

V E N D I M  
PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot ne dt. 07.08 2005, une gjyqtare e Gjykates Shkalles se Pare Tirane, pasi shqyrtova kerkesen e ortakut te vetem te shoqerise Leonard Liço i cili kerkon regjistrimin e shoqerise "LIÇO - TEK " shpk ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar:

K O N S T A T O V A

Se kerkesa e kerkuesit per regjistrimin e shoqerise tregtare te emertuar " LICO - TEK" Sh.p.k. me ortak te vetem dhe administrator z. Leonard Liço, me kapital 100.000 leke, me kohezgjatje te veprimtarise me afat te pacaktuar mbi 10 vjet me seli ne Korce, lgj.10, Blloku i Ri i Sportit, Pll.3, dhe me objekt te veprimtarise:

- Import eksport i artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve me shumice e pakice.

-Tregtim paisjesh elektro shtepiake, higjeno sanitare dhe hidraulike, punime hidraulike, tregtim dhe instalime impiantesh ngrohjeje, klimatizatoresh, kaldajash etj.

-Tregtim i artikujve te ndryshem industriale.

- Punime saldimi, gomisteri dhe servis automjetesh, lavazh.

-Tregtim automjetesh te cdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjese kembimi per to.

-Tregtim i artikujve te ndryshem ushqimore, me shumice dhe pakice.

-Tregtim makinerish te ndryshme e paisjesh industriale e bujqesore e venien e tyre ne shfrytezim.

-Trasport mallrash te te gjitha llojeve brenda e jashte vendit.

-Tregtimin e materialeve te ndertimit dhe lendeve te para brenda dhe jashte vendit.

Ne kushtet e mesiperme, kerkesa e kerkuesit eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj.

P E R K E T O A R S Y E

Ne baze te ligjit nr. 7638, dt. 19.11.1922 Per shoqerite tregtare" dhe atij nr. 7667, dt. 28.01.1993 " Per regjistrin tregtar"

## VENDOSA

Regjistrimin e shoqerise tregtare te emertuar " LICO - TEK" Sh.p.k. me ortak te vetem dhe administrator z. Leonard Liço, me kapital 100.000 leke, me kohezgjatje te veprimtarise me afat te pacaktuar mbi 10 vjet me seli ne Korce, lgj.10, Blloku i Ri i Sportit, Pll.3, dhe me objekt te veprimtarise:

- Import eksport i artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve me shumice e pakice.

-Tregtim paisjesh elektro shtepiake, higjeno sanitare dhe hidraulike, punime hidraulike, tregtim dhe instalime impiantesh ngrohjeje, klimatizatoresh, kaldajash etj.

-Tregtim i artikujve te ndryshem industriale.

- Punime saldimi, gomisteri dhe servis automjetesh, lavazh.

-Tregtim automjetesh te cdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjese kembimi per to.

-Tregtim i artikujve te ndryshem ushqimore, me shumice dhe pakice.

-Tregtim makinerish te ndryshme e paisjesh industriale e bujqesore e venien e tyre ne shfrytezim.


-Trasport mallrash te te gjitha llojeve brenda e jashte vendit.

-Tregtimin e materialeve te ndertimit dhe lendeve te para brenda dhe jashte vendit.

Kunder vendimit mund te behet ankim sipas ligjit.

GJYQTARE

*Ariane Caco*



**KONTRATË  
PËR THEMELIMIN E SHOQËRISË TREGËTARE  
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“LIÇO-TEK” Sh.p.k.**



E ortakut të vetëm:

LEONARD LIÇO, i biri i Kadriut i dtl. 1962, lindur dhe banues në Korçë, në adresën: Lagja 10, Blloku i Ri i Sportit, Pall. 3, me dokument identifikimi Pasaportë me nr. 0721579.

Madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në bazë të legjislacionit shqiptar, ka vendosur me vullnetin e tij të lirë e të plotë, për themelimin e shoqërisë tregëtare private, me përgjegjësi të kufizuar, të emërtuar “LIÇO-TEK” Sh.p.k., e cila do të rregullohet në mbështetje të Ligjit nr. 7512, dt. 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë të veprimtarisë private dhe privatizimit”, të Ligjit nr. 7638 dt. 19.11.1992 “Për shoqëritë tregëtare”, të Ligjit nr. 7667, dt. 28.01.1993 “Për Regjistrin Tregëtar”, si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe normave që vijnë:

**NENI 1**

Të themelojë një shoqëri tregëtare me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “LIÇO-TEK” Sh.p.k.

“LIÇO-TEK” Sh.p.k. është një subjekt juridik shqiptar, të cilit i lind e drejta të ushtrisë aktivitetin që nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregëtar pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Shoqëria “LIÇO-TEK” Sh.p.k. zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**NENI 2**

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive Tregëtare me përgjegjësi të kufizuar dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës të kontributit të derdhur në kapitalin themelor.

**NENI 3**

Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqërisë “LIÇO-TEK” Sh.p.k. do të jetë :

1. Import – eksport, tregëtim i artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve me shumicë e pakicë.
2. Tregëtim pajisjesh elektro-shtëpiake, higjieno sanitare dhe hidraulike, punime hidraulike, tregëtim dhe instalime impiantesh ngrohjeje, klimatizatorësh, kaldajash etj.
3. Tregëtim i artikujve të ndryshëm industrialë.
4. Punime saldimi, gomisteri dhe servis automjetesh, lavazh.
5. Tregëtim automjetesh të çdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjesë këmbimi për to.

*Leonard Lico*  
*[Signature]*

6. Tregtim i artikujve të ndryshëm ushqimorë, me shumicë dhe pakicë.
7. Tregtim makinerish të ndryshme e pajisjesh industriale dhe bujqësore e vënien e tyre në shfrytëzim.
8. Transport mallrash të të gjitha llojeve, brenda dhe jashte vendit.
9. Tregëtimin e materialeve te ndërtimit dhe lëndëve të para brenda dhe jashtë vendit.

#### NENI 4

Shoqëria "LIÇO-TEK" Sh.p.k. e ka selinë e saj në adresën: Lagja 10, Blloku i Ri i Sportit, Pall. 3, në Korçë.

Ajo ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë filiale, agjensi përfaqësimi, seli sekondare, degë sekondare dhe zyra duke patur të drejtën që t'i suprimojë ato.

#### NENI 5

Kapitali themeltar i shoqërisë "LIÇO-TEK" Sh.p.k. është 100.000 lekë dhe është i përbërë nga shuma në të holla e derdhur nga ortaku i vetëm, i cili e zotëron plotësisht këtë kapital.

#### NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar dhe mbi 10 vjet .  
Ajo shpërndahet me vendim te ortakut te vetëm z. **LEONARD LIÇO**.

#### NENI 7

I gjithë kapitali themelor është i ndarë në 100 pjesë të barabarta ku secila pjesë është e përbërë nga 1000 lekë.

I gjithë kapitali i vënë nga ortaku i vetem themelues është tërësisht dhe plotësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm nga ana e tij .

#### NENI 8

Fitimi i realizuar nga veprimtaria ekonomike e shoqërisë, pas shlyerjes së detyrimeve ligjore dhe atyre që kanë lindur me të tretët është plotësisht i transferueshëm dhe për t'u depozituar në një nga Bankat shqiptare ose për t'u përdorur sipas nevojave të ortakëve të shoqërisë.

#### NENI 9

Organet e shoqërisë "LIÇO-TEK" Sh.p.k. janë :

- Asambleja e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.
- Administratori i shoqërisë.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në Statutin e shoqërisë.  
Administrator i shoqërisë do të jetë z. **LEONARD LIÇO**.

*Leonard Lico*  
2 *Lico*

## NENI 10

Shoqëria Tregtare Private "LIÇO-TEK" Sh.p.k. është person juridik shqiptar dhe do të ushtrojë veprimtarinë e saj ekonomike private në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe veçanërisht ligjeve nr. 7512 dt. 10.08.1991, Ligjit nr. 7638 dt. 19.11.1992, dhe Ligjit nr. 7667 dt. 28.01.1993 të Kodit Civil si dhe të akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tyre.

## NENI 11

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet Kontratës së Punës që lidhet midis palëve në mbështetje të ligjit nr. 7961 ,datë 12.07.1995 ( Kodi i Punës ) si dhe akteve të tjera në zbatim të tij.

## NENI 12

Mosmarrëveshjet e mundshme që mund të lindin gjatë interpretimit apo zbatimit të kësaj kontrate, palët do t'i zgjidhin në rrugë miqësore, në të kundërt kompetenca për zgjidhjen e konfliktit i kalon Gjykatës së Rrethit Tiranë.

## NENI 13

Për sa nuk përshkruhet në këtë kontratë themelimi do të aplikohen nenet e Statutit të shoqërisë dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

## NENI 14

Kjo kontratë është përpiluar në katër kopje origjinale.

Korçë, më datë 05/09/2005

**ORTAKU THEMELUES**

**LEONARD LIÇO**  
*Leonard Lico*  
*[Signature]*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ZYRA E NOTERISE KORCE

Nr. 173P Prot.

Nr. 1736 Kol.



**VERTETIM NENSHKRIMI**

Vërtetohet se sot më dt. 05/09/2005 (dymijë e pesë), ditën e Hënë,  
paraqit personalisht para meje noteres VASILIKA PROKO, shtetasi i mëposhtëm:

LEONARD LIÇO, i biri i Kadriut i dtl. 1962, lindur dhe banues në Korçë,  
në adresën: Lagja 10, Biloku i Ri i Sportit, Pall. 3, me dokument identifikimi Pasaportë me  
nr. 0721579.

I lartpërmenduri është madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i verifikuar prej meje  
nëpërmjet dokumentit përkatës të identifikimit, dhe nënshkroi para meje noteres Statutin dhe  
Kontratën e Themelimit të Shoqërisë Private Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "LIÇO-TEK"  
Sh.p.k.

NOTERI  
VASILIKA PROKO





**STATUT**  
**I SHOQËRISË TREGËTARE ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“LIÇO-TEK” Sh.p.k.**

Shoqëria është krijuar mbi bazën e kontratës së ortakut të vetëm themelues të saj:

LEONARD LIÇO, i biri i Kadriut i dtl. 1962, lindur dhe banues në Korçë, në adresën: Lagja 10, Blloku i Ri i Sportit, Pall. 3, me dokument identifikimi Pasaportë me nr. 0721579.

Statuti është akti bazë ku do të mbështetet themelimi i shoqërisë tregtare private me përgjegjësi të kufizuar “LIÇO-TEK” Sh.p.k. si dhe zhvillimi i mëtejshëm i veprimtarisë së saj.

Për të bërë të mundur veprimtarinë ekonomike dhe organizimin e kësaj shoqërie në përputhje me Ligjin nr. 7512 dt. 10.08.1991, Ligjin nr. 7638 dt. 19.11.1992 si dhe Ligjin nr. 7667 dt. 28.01.1993 është përpiluar ky statut me kërkesat e ligjit për shoqëritë tregtare me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 1**  
**EMËRTIMI**

Shoqëria është quajtur “LIÇO-TEK” Sh.p.k.

Ajo është një subjekt juridik shqiptar, të cilit i lind e drejta të ushtrojë aktivitetin që nga data e regjistrimit të kësaj shoqërie në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Shoqëria “LIÇO-TEK” Sh.p.k. zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me aktet e themelimit të saj ( kontrata dhe statuti ).

**NENI 2**  
**OBJEKTI**

Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqërisë “LIÇO-TEK” Sh.p.k. do të jetë si më poshtë:

1. Import – eksport, tregëtim i artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve me shumicë e pakicë.
2. Tregëtim pajisjesh elektro-shtëpiake, higjieno sanitare dhe hidraulike, punime hidraulike, tregëtim dhe instalime impiantesh ngrohjeje, klimatizatorësh, kaldajash etj.
3. Tregëtim i artikujve të ndryshëm industrialë.
4. Punime saldimi, gomisteri dhe servis automjetesh, lavazh.
5. Tregëtim automjetesh të çdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjesë këmbimi për to.
6. Tregëtim i artikujve të ndryshëm ushqimorë, me shumicë dhe pakicë.
7. Tregëtim makinerish të ndryshme e pajisjesh industriale dhe bujqësore e vënien e tyre në shfrytëzim.

*Leonard Lico*  
*[Signature]*

8. Transport mallrash të të gjitha llojeve, brenda dhe jashtë vendit.
9. Tregëtimin e materialeve të ndërtimit dhe lëndëve të para brenda dhe jashtë vendit.

**NENI 3**  
**SELIA**

Shoqëria "LIÇO-TEK" Sh.p.k. e ka selinë në adresën: Lagja 10, Blloku i Ri i Sportit, Pall. 3.  
Ajo ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë filiale, agjensi përfaqësimi, seli sekondare si dhe t'i suprimojë ato.  
Çdo ndryshim i selisë do të bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.

**NENI 4**  
**KOHËZGJATJA**

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje me një afat të pacaktuar e mbi 10 vjet.  
Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm .

**NENI 5**  
**KAPITALI**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë dhe është i përbërë nga shuma në të holla e derdhur nga ortaku i vetëm.

**NENI 6**

I gjithë kapitali themeltar është i ndarë në 100 pjesë të barabarta ku secila pjesë është e barabartë me nga 1.000 lekë.


**NENI 7**

Shoqëria mund të rritë kapitalin themelor ose mund ta zvogëlojë atë, por gjithnjë jo nën kufirin 100.000 lekëve, që përcaktohet në Ligjin nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregëtare me përgjegjësi të kufizuar".

Shtimi ose pakësimi i kapitalit bëhet me vendim të Asamblesë së Shoqërisë dhe sipas kërkesave të ligjit.

**NENI 8**

Fitimi i realizuar nga ushtrimi i veprimtarisë ekonomike të shoqërisë do të administrohet nga ortaku i vetëm i shoqërisë.  
Një pjesë e këtij fitimi mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit tregëtar.

Leonard Ljep  




Shoqëria është e detyruar të shlyejë të gjitha detyrimet që ka ndaj shtetit dhe ndaj të tretëve.

#### **NENI 9**

Shoqëria është disponuese dhe përdoruese e pasurisë së saj. Ajo mund të blejë e të shfrytëzojë të drejta të tjera materiale ose jo materiale duke përfshirë edhe të drejtën për shitjen e pasurisë së vet tek të tretët.

Në Republikën e Shqipërisë "LIÇO-TEK" Sh.p.k. gëzon të drejta sikundër çdo person tjetër juridik ose fizik, shqiptar ose i huaj në përputhje me legjislacionin shqiptar.

#### **NENI 10**

Shoqëria ka të hapur llogarinë e saj rrjedhëse në Bankë, nëpërmjet së cilës kryhen veprime ekonomiko-financiare me partnerë të tretë vendas dhe të huaj duke likuiduar në monedhë shqiptare apo të huaj sipas marrëveshjes të përfunduar midis tyre.

#### **NENI 11**

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- Asambleja e shoqërisë .
- Administratori i shoqërisë.

Asambleja është organi vendimor i shoqërisë. Ajo mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme. Asambleja e zakonshme thirret të paktën dy herë në vit mbas mbylljes së vitit financiar dhe kur aprovohet programi i veprimtarisë për vitin e ardhshëm.

Asambleja e jashtëzakonshme thirret kur administratori i shoqërisë e quan të përshtatshme për kërkesat e shoqërisë. I takon asamblesë të jashtëzakonshme të bëjë ndryshime në Statutin e shoqërisë, të pakësojë ose të shtojë kapitalin themelor, të shpërndajë para afatit Shoqërinë ose të shtyjë aktivitetin e saj. Për të mbajtur procesverbalin e mbledhjeve të Asamblesë caktohet një sekretar që mund të jetë edhe një Noter. Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Administratori i Shoqërisë, nga sekretari dhe nga të gjithë pjesëmarrësit .

Administrator i Shoqërisë "LIÇO-TEK" Sh.p.k. u caktua z. LEONARD LIÇO.

#### **NENI 12**

Administratorit të shoqërisë i takon administrimi i zakonshëm i shoqërisë.

I takon Administratorit të Shoqërisë të përfaqësojë Shoqërinë përpara të tretëve dhe në gjykim. Ai gëzon të drejtën e firmës së Shoqërisë.

Administratori mund t'i delegojë të drejtat e veta një personi të tretë të autorizuar me shkrim për të përfaqësuar shoqërinë si dhe të kryejë veprime dhe praktika të ndryshme në emër të tij.

*Leonard Lico*  
*[Signature]*

### ***NENI 13***

Asambleja ka këto kompetenca dhe të drejtën të marrë këto vendime :

- Të miratojë programin e veprimtarisë së Shoqërisë.
- Të hartojë raportet e administrimit, inventaret dhe llogaritë vjetore.
- Vendos për shpërndarjen e shoqërisë, për ndarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve.
- Rregullon marrëdhëniet e punësimit dhe ato të shpërblimit brenda shoqërisë.
- Emëron dhe shkarkon ekspertë kontabël.
- Bën ndryshime e plotësime në Statut dhe në Kontratën e Themelimit.
- Vendos për rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themelor, për kalimin e kapitalit të tretët, për ndryshimin e kohës së veprimtarisë, për shndërrimin e shoqërisë në një shoqëri të një forme tjetër, për likuidimin e shoqërisë.
- Sipas akteve ligjore bën shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve shtetërore, personave juridikë ose fizikë, vendas e të huaj.

### ***NENI 14***

Kontrolli financiar i shoqërisë kryhet nga një ose më shumë ekspertë kontabël.

### ***NENI 15***

Llogaritë vjetore, inventaret, raporti mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga ekspertët kontabël miratohen nga Asambleja e Shoqërisë. Miratimi i dokumentave financiare vjetore bëhet brenda një afati tremujor pas datës së shlyerjes së vitit financiar.

### ***NENI 16***

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe vërtetimit të ekzistencës së fitimit, Asambleja vendos dhe krijon fondin ligjor, por mund të krijojë edhe fonde të tjera. Shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, për afatet e derdhjes së sigurimeve shoqërore etj. Ajo ka të drejtë të çelë llogari likujduese pranë Bankave të vendit dhe të kryejë veprimtari likujduese nëpërmjet tyre.

### ***NENI 17***

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Administratori ose personat e caktuar prej tij janë të detyruar të paraqesin bilancin vjetor dhe deklaratën e të ardhurave dhe t'i depozitojnë në organin financiar kompetent të Zyrës së Tatim Taksave.

*de non / deo*  
*[Signature]*

## **NENI 18**

Marrëdhëniet e punësimit brenda shoqërisë rregullohen nëpërmjet Kontratës së Punësimit që lidhet midis palëve në përputhje me ligjin nr. 7961, dt. 12.07.1995 si dhe legjislacionin tjetër shqiptar që bën fjalë për punësimin.

## **NENI 19**

Marrja në punë bëhet me regjistrimin nga punëdhënësi në Librin e Punës së Shoqërisë si dhe duke njoftuar organet e punës së juridiksionit ku ushtron veprimtarinë Shoqëria. Largimi nga puna ose ndryshimi i vendit të punës bëhet në bazë të një akti të lëshuar me shkrim nga Administratori i Shoqërisë. Largimi lidhet me mbarimin e kontratës së punës, bëhet për shkelje disiplinore ose dhe me kërkesën e vetë të interesuarit. Largimi nga Shoqëria bëhet mbasi të jenë shlyer të gjitha detyrimet materiale dhe monetare.

## **NENI 20**

Shoqëria mund të lidhë kontrata me sektorë shtetërorë drejtpërdrejt në tregun e lirë si dhe me persona fizikë ose juridikë vendas ose të huaj. Në veprimet kontraktuale shoqëria përfaqësohet nga administratori i Shoqërisë **z. LEONARD LIÇO**. Ajo mund të përfaqësohet edhe nga persona të tjerë të përcaktuar prej tyre me prokurë. Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontratat janë të detyrueshme për shoqërinë.

## **NENI 21**

Shoqëria mund të shpërbëhet para afatit të caktuar në këtë statut në rast kur ndryshon afati ose kur ka një shpërbërje të parakohshme për shkaqe të tjera.

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e shpërbërjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi emërohen një ose disa likuidatorë, të cilët ndjekin operacionin e likuidimit deri në fund dhe i paraqesin Asamblesë rezultatet përfundimtare të likuidimit.

Në përfundim Asambleja vendos që të gjitha detyrimet që dalin nga akti i likuidimit t'i marrë përsipër për t'i shlyer ortaku i vetëm me kapitalin e tij.

## **NENI 22**

Të gjitha mosmarrëveshjet që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim midis Shoqërisë dhe të tretëve do të zgjidhen nëpërmjet Gjykatës së Rrethit Tiranë ku ndodhet edhe Regjistri Tregëtar i Shoqërisë.

## **NENI 23**

Çështjet e tjera të patrajtuara në këtë Statut do të mbështeten për zbatim në legjislacionin shqiptar në fuqi sipas rastit konkret si në Ligjin nr. 7512 dt. 10.08.1991,

*Leonard Liço*  
*[Signature]*

në Ligjin nr. 7638 dt. 19.11.1992, në Ligjin nr. 7667 dt. 28.01.1993 dhe në Kodin Civil si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në zbatim të tyre.

#### ***NENI 24***

Ndryshimi i formës së Shoqërisë në shoqëri me formë tjetër bëhet me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm kur plotësohen kushtet për krijimin e llojeve të tjera.

#### ***NENI 25***

Asambleja e Shoqërisë mund të bëjë ndryshime e plotësime në çdo kohë në Statut e në Kontratën e Themelimit pa rënë ndesh në mënyrë thelbësore me Nenet që janë përshkruar në këtë Statut. Ndryshimet dhe plotësimet në Statut e në Kontratën e Themelimit bëhen në të njëjtën mënyrë e procedurë me të cilën nxirret vetë Statuti.

#### ***NENI 26***


Shoqëria do të ketë vulën e saj me madhësi të zakonshme e me tekst përreth saj.

#### ***NENI 27***

Statuti është hartuar me vullnetin e lirë dhe të plotë të ortakut themelues dhe është nënshkruar prej tij.

Statuti hartohet në katër kopje për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.

**ORTAKU THEMELUES  
LEONARD LIÇO**



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ZYRA E NOTERISE KORCE

Nr. 1736 Prot.  
Nr. 1736 Kol.



**VERTETIM NENSHKRIMI**

Vërtetohet se sot më dt. 05/09/2005 (dymijë e pesë), ditën e Hënë,  
u paraqit personalisht para meje noteres VASILIKA PROKO, shtetasi i mëposhtëm:

LEONARD LIÇO, i biri i Kadriut i dtl. 1962, lindur dhe banues në Korçë,  
në adresën: Lagja 10, Blloku i Ri i Sportit, Pall. 3, me dokument identifikimi Pasaportë me  
nr. 0721579.

I lartpërmenduri është madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i verifikuar prej meje  
pëpërmjet dokumentit përkatës të identifikimit, dhe nënshkroi para meje noteres Statutin dhe  
Kontratën e Themelimit të Shoqërisë Private Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "LIÇO-TEK"  
Sh.p.k.



NOTERI  
VASILIKA PROKO

33919

3 Arianna Cervo

06



**KERKESE**

**E**

PULLE TAKSE

R.SHQËRISË

LEKE  
100

PULLE TAKSE

R.SHQËRISË

LEKE  
100

**KERKUESIT:**

LEONARD LIÇO, i biri i Kadriut i dtl. 1962  
lindur dhe banues në Korçë, në adresën Lagja 10, Blloku i Ri i Sportit, Pall. 3, me dokument identifikimi Pasaportë me nr. 0721579.

PULLE TAKSE

R.SHQËRISË

LEKE  
100

**ME OBJEKT:**

Kërkoj regjistrimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "LIÇO-TEK" Sh.p.k. me seli në Lagja 10, Blloku i Ri i Sportit, Pall. 3, Korçë, bazuar në Ligjin nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin nr. 7667 dt. 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar".-

PULLE TAKSE

R.SHQËRISË

LEKE  
100

**GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË  
TIRANË**

PULLE TAKSE

R.SHQËRISË

LEKE  
100

Unë kërkuesi i mësipërm kam themeluar Shoqërinë Tregtare Private "LIÇO-TEK" Sh.p.k. konform legjisllacionit shqiptar në fuqi.

Kjo shoqëri do të zhvillojë aktivitetin e saj bazuar në Statutin dhe në Kontratën e hemelimit të saj.

Për të bërë të mundur zhvillimin e aktivitetit të kësaj shoqërie me seli në Lagja 10, Blloku i Ri i Sportit, Pall. 3, Korçë, kërkoj nga ana e kësaj Gjykate regjistrimin e saj si person juridik në Regjistrin Tregëtar, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Bashkëngjitur kësaj kërkesë ju paraqes Statutin dhe Kontratën e Themelimit të shoqërisë Tregëtare "LIÇO-TEK" Sh.p.k. si dhe Aktin e Depozitimit të Kapitalit me dt. 05/09/2005.

PULLE TAKSE

R.SHQËRISË

LEKE  
100

PULLE TAKSE

R.SHQËRISË

LEKE  
100

**KERKUESI  
LEONARD LIÇO**

*Leonard Ligo*  
*[Signature]*

PULLE TAKSE

R.SHQËRISË

LEKE  
100

PULLE TAKSE

R.SHQËRISË

LEKE  
100

PULLE TAKSE

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ZYKA E NOTERISE KORCE

Nr. 1338 Prot.  
Nr. 1276 Kol.

### VERTETIM NENSHKRIMI

Vërtetohet se sot më dt. 05/09/2005 (dymijë e pesë), ditën e Hënë,  
u paraqit personalisht para meje noteres VASILIKA PROKO, shtetasi i mëposhtëm:

LEONARD LICO, i biri i Kadriut i dtl. 1962, lindur dhe banues në Korçë, në  
adresën: Lagja 10, Blloku i Ri i Sportit, Pall. 3, me dokument identifikimi Pasaportë me nr.  
0721579.

I lartpërmenduri është madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i verifikuar prej meje  
nëpërmjet dokumentit përkatës të identifikimit, dhe nënshkroi para meje noteres Kërkesën për  
Regjistrim pranë Regjistrit Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, të Shoqërisë Private  
Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "LIÇO-TEK" Sh.p.k.



NOTERI  
VASILIKA PROKO

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**DHOMA E NOTERISE KORÇE**

Nr. 1398 Prot.

Nr. 1736 Kol.



**AKT DEPOZITIMI KAPITALI**

Sot më datë 05/09/2005, ditën e Hënë para meje  
VASILIKA PROKO, Notere Publike, anëtare e Dhomës së Noterisë Korçë, u  
paraqit personalisht para meje ortaku i vetëm :

LEONARD LIÇO, i biri i Kadriut i dtl. 1962, lindur dhe banues në  
Korçë, në adresën: Lagja 10, Blloku i Ri i Sportit, Pall. 3, me dokument identifikimi  
Pasaportë me nr. 0721579.

I lartpërmenduri është madhor, i aftë për të kryer veprime juridike, i panjohur prej  
meje, për identitetin e të cilit u sigurova nëpërmjet dokumentit përkatës të  
identifikimit, Pasaportës së tij me nr. 0721579, i cili deklaroi sa vijon:  
Si ortak i Shoqërisë në formim e sipër "LIÇO-TEK" Sh.p.k., depozitoj pranë  
Zyrës së Noterisë kapitalin fillestar në shumën e 100.000 lekëve.

Kjo shumë do të qëndrojë e ngurtësuar pranë Zyrës Noteriale Korçë derisa të bëhet  
regjistrimi i Shoqërisë së tij "LIÇO-TEK" Sh.p.k., në Regjistrin Tregtar pranë  
Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Sa më sipër, lexohet ky akt depozitimi me përmbajtjen e të cilit ortaku i  
vetëm i shoqërisë së sipërpërmendur ishte dakort dhe e nënshkroi atë rregullisht  
para meje Noteres.

ORTAKU I VETEM  
**LEONARD LIÇO**

*Leonard Liço*



NOTERE  
**VASILIKA PROKO**

*Vasilika Proko*